



Pranimi / Dostava / Received / Delivery	23.06.2021	1	viti / god / year
Organ / Organizacija / Org. / Org.	SKPMSTK	3292/2021	114



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. nr. 485/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari kryetare Eshref Shabani dhe Jeton Koca, - anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2985/2019 të datës 19.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative të kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 662/2019, të datës 28.10.2019, të ankuesit me adresë banimi rruga lagja Ulpiana A 5 hyrja 4 numër 5 nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, , si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.06.2021 mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A. nr. 662/2019, e datës 28.10.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET procedura e rekrutimit për pozitën „Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore“ e shpallur sipas konkursit me numër 697 të datës 17.09.2019 nga Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës dhe Menaxheri i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 10.09.2019, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për „Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore”, nga Ministria e Administratës Publike, ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 17.09.2019, ka shpallur konkursin për pozitën „Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore” në Administratën Tatimore të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me shpalljen e konkursit të datës 17.09.2019, nga Administrata Tatimore e Kosovës brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjit Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.10.2019, ka parashtruar ankese me numër protokolli 5077/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore”, në Administratën Tatimore të Kosovës, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 31.10.2019, me numër protokolli 5113/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datën 11.11.2019 me numër protokolli 5321/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 05.11.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 19.05.2021, me numër A.nr. 2985/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditës të vendos lidhur me aneksen e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 662/2019, e datës 28.10.2019, me numër protokolli 5077/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 17.09.2019; Njoftimi i kandidateve për testim nga përzgjedhja e ngushtë; Njoftimi i datës 04.10.2019; Njoftimi i datës 09.10.2019; Akt emërimi i datës 27.03.2019; Akt emërimi i datës 28.02.2013; Vendimi i datës 07.04.2016; Rregullorja Nr. ATK , 13/2019, per Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK; Autorizimi i datës 10.09.2019, i Ministrisë së Administratës Publike; Konkursi i datës 17.09.2019; Vendimi i datës 25.09.2019, për themelimin e Komisionit përzgjedhës; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuar; Përcaktimi i Kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë; Përmbledhja e vërshimeve individuale; Renditja Përfundimtare e kandidateve; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni rekrutues; kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 08.07.1999; Vendimi i datës 29.08.2017; Certifikatë; Testi me shkrim; Akt emërimi i datës 14.02.2014; Kërkesa për punësim e Jeton Dragusha, me shkresat e bashkangjitura; Kontrata e punësimit e datës

26.07.2000; Akt emërimi i datës 23.02.2012; Akt emërimi i datës 10.06.2013; Akt emërimi i datës 10.06.2013; Njoftimi i datës 05.11.2019, i Këshillit; Përgjigje në ankese e datës 11.11.2019, me numër protokoll 5321/2019, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën „Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore“, i cili pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të provave dhe dëshmive të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi ka konstatuar se më datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë i cili në bazë të nenit 85 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë janë shfuqizuar edhe të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që institucionet kanë qenë të obliguara që të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa për procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, atëherë procedurat do të vazhdojnë sipas ligjit të ri siç përcaktohet me dispozitat e nenit 83 paragrafit 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, i përcakton që: *“Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri”*, rrjedhimisht Administrata Tatimore e Kosovës procedurën e lartcekur të rekrutimit e ka zhvilluar duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil edhe pse në këtë afat kohorë në fuqi ka qenë Ligji Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë i cili parasheh ndryshime të tërësishme lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu ende nuk kemi akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji e të cilat në mënyrë të hollësishme do të përcaktonin mënyrën e zhvillimit të procedurave të rekrutimit kështu që çdo procedurë e zhvilluar pas datës 11.09.2019 duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është në kundërshtim me nenin 83 paragrafin 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, në këtë rast edhe procedura e rekrutimit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore”, nga Administrata Tatimore e Kosovës” e zhvilluar nga Administrata Tatimore e Kosovës, është e pavlefshme për arsyet e lartcekura.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr.485/2021

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratës Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

